



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2021

V E N D I M

Nr. 24, datë 12/02/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 130, datë 12.11.2020, e disa ish-punonjëseve të Xibritex sh.p.k., përkatësisht znj. Xh. B., znj. R. L. dhe znj. V. R., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjinisë*” dhe “*gjendjes ekonomike*”, nga ana e Xibritex sh.p.k.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se ankueset kanë qenë punonjëse fasonerie pranë Xibritex sh.p.k. dhe janë larguar të gjitha nga puna në mënyrë të menjëherëshme, në datën 09.07.2020. Mbështetur në informacionin e dhënë në ankesë, në këtë datë janë larguar nga puna 30 punonjëse nga Xibritex sh.p.k., si pasojë e rënies së aktivitetit të shoqërisë.

Ankueset pretendojnë gjithashtu se Xibritex sh.p.k. nuk u ka paguar pagat e muajve maj - korrik 2020, si dhe nuk u janë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, megjithëse ato kanë punuar çdo ditë dhe shoqëria ka patur aktivitet të rregullt, edhe gjatë pandemisë. Njëkohësisht, ato pretendojnë se për pjesën tjetër të punonjësve të larguar nga puna ka ndodhur e kundërta, pasi ndaj tyre shoqëria ka shlyer detyrimet e mësipërme. Të gjitha

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

ankueset janë femra dhe pretendojnë se një nga shkaqet e gjithë qendrimit të mbajtur ndaj tyre është gjinia. Njëkohësisht, ato pretendojnë se diskriminimi i kryer ndaj tyre ka lidhje edhe me gjendjen e tyre ekonomike. Ankueset pretendojnë se ndodhen në gjendje të vështirë ekonomike dhe pjesa më e madhe e tyre kanë fëmijë të mitur. Në këtë kontekst, ankueset pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë, disfavorizuese dhe të padrejtë nga ana e punëdhënësit për shkak të gjinisë dhe gjendjes ekonomike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, të miratuara me ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””². Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”³, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*gjinisë*” dhe “*gjendjes ekonomike*”, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

² Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Neni 3, i Ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa në Kreun II, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, të tij parashikon se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës; ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfutuar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7 të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 130, datë 12.11.2020, e disa ish-punonjëseve të Xibritex sh.p.k., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Meqënëse, shkresa nr. 1445/3, datë 04.11.2020, me lëndë “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, e Komisionerit, e dërguar në adresë të Xibritex sh.p.k., për shqyrtimin e

ankesës nr. 123/2020⁴, të disa ish-punonjësve të kësaj shoqërie, ishte kthyer mbrapsht nga shërbimi postar me shënimin se subjekti ishte larguar nga ajo adresë, Komisioneri kreu verifikimet përkatëse në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit, ku konstatoi se subjekti Xibritex sh.p.k. rezultonte të kishte të njëjtën adresë, në të cilën KMD kishte dërguar shkresën e sipërcituar. Në kushtet kur, nuk disponohej një adresë e vlefshme e Xibritex sh.p.k., KMD kontaktoi me avokaten e ankueseve, e cila ofroi një adresë tjetër, që i përkiste administratorit të kësaj shoqërie.

Në vijim, mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua nëpërmjet shkresës nr. 1702, datë 07.12.2020, administratorit të Xibritex sh.p.k., ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankueseve, duke evidentuar dhe provuar qartë shkakun/qet e zgjidhjes së kontratave individuale të punës;
- Kopje të kontratave individuale të punës për të gjitha ankueset;
- Kopje të librezave të punës për të gjitha ankueset;
- Praktika e zgjidhjes së kontratës së punës për të gjitha ankueset;
- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të Xibritex sh.p.k. deri në muajin qershor 2020;
- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të punëdhënësve, që u është zgjidhur kontrata individuale e punës, në muajin korrik 2020, si dhe të dërgohet lista emërore e tyre, ku të jenë evidentuar pozicionet përkatëse të punës;
- Numri i punonjësve, që aktualisht punojnë pranë Xibritex sh.p.k., si dhe lista e tyre emërore, ku të evidentohen pozicionet e punës për secilin prej tyre;
- Informacion mbi arsyet e mosdhënies së pagave dhe mos kryerjes së pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shendetësore, për ankueset, për periudhën maj-korrik 2020;

⁴ Ankesa në fjalë ka objekt të njëjtë me ankesën nr. 130, datë 12.11.2020, si dhe drejtohet kundër të njëjtit subjekt, përkatësisht Xibritex sh.p.k.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Informacion nëse detyrimet e mësipërme janë shlyer nga shoqëria për një pjesë të punonjësve, që u është zgjidhur kontrata e individuale e punës në korrik 2020. Nëse po, të dërgohet lista emërore e punonjësve përkatës;

- Administratori i Xibritex sh.p.k. nuk dërgoi përgjigje në adresë të KMD-së.

- Për efekt të shqyrtimit të ankesës nr. 123/2020, e cila ka patur objekt të njëjtë me ankesën nr. 130, datë 12.11.2020, si dhe drejtohet kundër të njëjtit subjekt, Komisioneri i është drejtuar me shkresën nr. 1565 prot., datë 12.11.2020, me lëndë “*Kërkesë për informacion*”, Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Shkresa iu dërgua për dijëni edhe avokates R. A., e cila përfaqësonte me prokurë të posaçme, grupin e parë të ankuesëve kundër Xibritex sh.p.k., pranë KMD-së.

Në shkresë kërkohej informacioni i mëposhtëm:

- Adresa e saktë e Shoqërisë “Xibritex” sh.p.k.;
 - Informacion, nëse subjekti i mësipërm është aktiv dhe aktualisht paguan detyrimet tatimore përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Nëse jo, të përcaktohet muaji i fundit kur subjekti Xibritex sh.p.k. ka kryer shlyerjen e detyrimeve tatimore përkatëse;
 - Kopje të akteve “*Deklarata të të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si edhe të larguarve nga puna*” për periudhën maj- nëntor 2020;
 - Informacion nëse ankueset kanë depozituar ankesë pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ndaj Xibritex sh.p.k. Nëse po, të dërgohet praktika e shqyrtimit të ankesave respektive;
 - Informacion nëse subjekti Xibritex sh.p.k. nuk ka paguar pagat e ankuesëve për periudhën maj-korrik 2020;
 - Informacion nëse Xibritex sh.p.k. ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të ankuesëve për muajt maj-korrik 2020;
 - Informacion nëse Xibritex sh.p.k. vazhdon të paguajë sigurimet shoqërore për punonjësit e tij, nga muaji korrik 2020 e në vijim;
- Në përgjigje të shkresës nr.1565 prot., datë 12.11.2020, të KMD-së, Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dërgoi shkresën nr. 561/3, datë 18.11.2020, nëpërmjet së cilës e informon KMD-së si më poshtë vijon:

“Subjekti “Xibritex” me Nipt L51909025G aktualisht nuk kryen aktivitet fizik në adresën e deklaruar në QKB, kjo sipas verifikimeve të kryera nga grupi i inspektorëve në terren. Pranë Inspektoriatit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë depozituar ankesa nga tre punonjëse të kësaj kompanie, përkatësisht znj. G. T., znj. A. D. dhe znj. Dh. M.

Ndaj subjektit “Xibritex” me Nipt L51909025G, në datë 16.07.2020 është kryer një inspektim me objekt “denoncim nga të tretët”, e iniciuar nga ankesa e drejtuar nga znj. G. T. pranë institucionit tonë. Subjekti si pasojë e mungesës së punës nga kontraktuesi i tij ka mbyllur fizikisht aktivitetin e tij prodhues. Si rezultat i kësaj situatë ai ka ndërprerë marrëdhënien e punës me të gjithë punëmarrësit në datë 05.07.2020, kjo e vërtetuar nga “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna”. Grupi i inspektorëve gjatë vizitës në subjekt në datë 16.07.2020, ka konstatuar që ambientet e punës ishin të boshatisura. Për sa i përket pretendimeve të punëmarrësve për pagat e pamarra, grupi i inspektorëve nga takimi që realizoi me punëmarrësit e subjektit u informua që nuk ishin likuaduar pagat e muajit Maj, Qershor 2020 dhe paga për ditët e punuara të muajit korrik 2020. Pas insistimit të inspektorëve u arrit të bëhej pagesa për muajin maj 2020 për të gjithë punonjësit. Në lidhje me pretendimin për mos pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, konstatoam që subjekti nuk i ka kryer ato. Kjo situatë është përsëritur për këtë subjekt nisur edhe nga inspektimet e mëparshme të kryera pranë këtij subjekti qysh në vitin 2018. Gjithashtu inspektorët e punës i janë drejtuar me shkresën nr. 531 Prot., datë 21.07.2020, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve si organi kompetent për mbledhjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në përfundim të procesit të inspektimit, grupi i inspektorëve konstatoi shkelje të kërkesave ligjore të evidentuara në dokumentacionin e inspektimit “Vendim Përfundimtar i Inspektimit Nr. ISHPSHSH – TR-2020-001886-5, datë 24.08.2020.....”.

- Në përgjigje të shkresës nr.1565 prot., datë 12.11.2020, të KMD-së, Instituti i Sigurimeve Shoqërore Dega Rajonale Tiranë dërgoi shkresën nr. 23765/1, datë 18.11.2020, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se për të përcjellë informacionin e kërkuar, është e nevojshme të disponohen kopje të kartave të identitetit të ankueseve.
- Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 1618 Prot., datë 23.11.2020, KMD iu drejtua sërish Institutit të Sigurimeve Shoqërore Dega Rajonale Tiranë, duke i dërguar bashkëlidhur emrat dhe kopje të kartave të identitetit të ish-punonjëseve të Xibritex sh.p.k., që kishin depozituar ankesat nr. 123/2020 dhe nr. 130/2020;
- Me shkresën nr. 25066/1, datë 27.11.2020, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë informon KMD-në se bashkëlidhur shkresës dërgohej vërtetimi i bazës së vlerësuar në

emër të shtetaseve të listuara, të dhëna sipas sistemit informatik të pagesës së kontributeve, i cili përmban periudhën janar 2012 e në vazhdim. Sipas vërtetimeve, rezultoi se për vitin 2020, për të gjitha ankueset është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore vetëm për muajin janar nga ana e Xibritex sh.p.k.

C. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

D. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueseve.

Në ankesën nr. 130, datë 12.11.2020, të disa ish-punonjëseve të Xibritex sh.p.k., të përfaqësuara me prokurë të posaçme nga Av. R. A., pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “gjendjes ekonomike”, nga ana e Xibritex sh.p.k.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndoqi të gjithë hapat e nevojshëm, administrativë, për shqyrtimin e pretendimeve të ish-punonjëseve të Xibritex sh.p.k. Referuar shkresës nr. 561/3, datë 18.11.2020, së Degës Rajonale Tiranë të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore rezultoi se: “Subjekti si pasojë e mungesës së punës nga kontraktuesi i tij ka mbyllur fizikisht aktivitetin e tij prodhues. Si rezultat i kësaj situate ai ka ndërprerë marrëdhënien e punës me të gjithë punëmarrësit në datë 05.07.2020, kjo e vërtetuar nga “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna””

Në pamundësi për të kontaktuar me Xibritex sh.p.k., i cili është subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa e sipërcituar, si dhe në kushtet kur ky subjekt e ka mbyllur aktivitetin e tij prodhues, Komisioneri gjykon se nuk mund të vërtetohet situata diskriminuese e pretenduar nga grupi i ish-punonjëseve të kësaj shoqërie dhe në bazë të parashikimit të nenit 95, e Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet shprehimisht: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, KMD vendosi ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në rastin konkret, KMD gjykon se objekti i kësaj procedure hetimore është bërë i pamundur, pasi kryerja e veprimeve administrative për shqyrtimin e ankesës kanë

humbur aktualitetin e tyre, për shkak të ndryshimit të rrethanave, të cilat mund të jenë faktike ose ligjore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neneve 13 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes, për shkak se Xibritex sh.p.k. e ka mbyllur fizikisht aktivitetin e tij, prodhues.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – Punësim
Shkak – gjinia, gjendja ekonomike.
Lloji i vendimit – pushim shqyrtimi